

VENDIM
Nr.537, datë 21.12.1992

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.393, DATË 3.9.1992 "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE"

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992, pikë 17 zëvendësohet si vijon:

1. Punonjësit efektivë në institucionet pedagogjike ose kërkimore-shkencore kur kanë tituj e grada shkencore e punojnë në vende pune që kërkojnë titull ose grada shkencore, marrin këto paga mujore:

- Profesor	5000 lekë
- Doktor i shkencave	4500 lekë
- Docent, bashkëpunëtor i vjetër shkencor	4000 lekë
- Kandidat i shkencave	klasa XXI

2. Punonjësit që kanë tituj e grada shkencore dhe nuk janë efektivë në institucionet pedagogjike ose kërkimore shkencore, por janë bashkëpunëtorë me veprimtarinë e tyre, u jepet shpërblim mujor për titullin a gradën përkatëse si më poshtë:

- Profesor	650 lekë
- Doktor i shkencave	600 lekë
- Docent, bashkëpunëtor i vjetër shkencor	520 lekë
- Kandidat i shkencave	450 lekë

Vendet e punës që kërkojnë punonjës me tituj e grada shkencore, caktohen nga ministrat përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij që nga data 1 dhjetor 1992.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi